

Libra të botuara:

"Te kulla e Adem Jasharit"
(poezi) 1999

"Përmes Shqipërisë"
(poezi) 1999

"Harku i Lahutës"
(poezi) 2000

"Jam Unë" (poezi) 2005

"Këtu jam që sot e mot"
(poezi) 2006

"Sfida dhe kurthe"
(Publicistikë) 2006

"Mall i gjakut tim"
(poezi) 2007

"Pelegrinë në Janinë"
(poezi) 2007

"Maratonë e heshtur"
(poezi) 2008

"Klithmë e nëndheshme"
(poezi) 2008

"Dolli e gjakut" (poezi) 2009

"Udhët e yjve" (roman) 2009

"Ankthi i artë" (roman) 2009

"Vargu magjik" (roman) 2009

"Nën lëmshin e kohëve"
(satira dhe tregime) 2009


"Stinë pa diej" (poezi) 2010

"Ky Dhe ka zot"
(monodramë) 2010

"Vargu Magjik II"
(roman) 2011

Lebit Murtishi - KOSOVA NUK DI TË VDESË!

Lebit Murtishi



KOSOVA NUK DI TË VDESË!
(dramë në katër akte)

DRAMË NË KATËR AKTE

Personazhet:

Fehmiu...Fehmi Lladrovci

Xheva.....Xhevë Lladrovci

Plaku.....(Baci)-I ati i Fehmiut

Lokja.....Nëna e Fehmiut

Arbri.....Ushtari UÇK-ës

Asllani....Asllan Fazliu (ushtari UÇK-ës)

Fatimja...Fatime Etemi (ushtare UÇK-ës)

Ushtari parë...

Uashtari dytë...

Ushtari tretë...

Ushtari katërt...

Autori:

Lebit Murtishi

Redaktor:

Kadri Sherifi

Lektor:

Zekë Krasniqi

Kopertina:

Sabir Krasniqi

Bern 2011

Lebit Murtishi

Kosova nuk di të Vdesë!

(dramë në katër akte)

Në përkujtim të dëshmorëve:
(XHEVË E FEHMI LLADROVCI)

DRAMË NË KATËR AKTE

Akti i parë

(oda e madhe me frengji...rreth oxhakut rrinë ulur pleqtë e Fehmiut..dëgjohen krisma të largëta... është kohë lufte)

Plaku-

(thith tymin e duhanit dhe kollet dy-tri herë)

Lokja-

nuk fole gjë o im zot!
je ngulur tek rrënjë e oxhakut
e s` të shpëton një gjysmë fjale...

së paku një gjysmë fjale të kishe sjellë në shtëpi
nga ç`ke dëgjuar e ç`ke parë
jashtë kësaj heshtjeje të gurtë...

Plaku-

(pa lëvizur sytë nga oxhaku)

mbase mjaftojnë këto krisma...
kush ka sy edhe veshë nuk i duhet kallauz!..

Lokja-

mbase...pooor...ndonjëherë një fjalë e mirë
peshon më shumë se një mijë çifligje...

Plaku-

të thjeshtë e ka gjuhën lufta...
të thjeshtë dhe të mprehtë...
nuk i duhen fjalë të mira...
e kuptojnë edhe gurët...

Lokja-

hë pra! hape një herë,
thuaj diçka, dosido...

Plaku-

asgjë s`ndryshon një fjalë më shumë...
të moçmit tanë thoshin dikur: kur s`ke ç` të thuash
më mirë të heshtësh...

Lokja-

eeh ç`kohë!
as të flasësh as të heshtësh...
kë të lëshë e kë të zgjedhësh...

Plaku-

se mos mbeti gjë për të zgjedhur!
Të rënda i ka hesapet kjo kohë, të rënda...

Lokja-

Për ç`hesape e ke fjalën, im zot!..

Plaku-

për hesapet e kësaj kohe,
që na rri si re mbi kokë
e s` dihet çka e sa do pjellë...

Lokja-

të sigurta janë vetëm vdekjet...
po... nuk e di a do të thuhen ndonjëherë
gjithë mynxyrat e kësaj kohe...

Plaku-

di t`i thonë brezat që vijnë,
ata do kenë kohë më tepër...
e do t`i numërojnë të gjitha... një për një ... sot...

Lokja-

a do të flasin edhe për nënat o im zot!

Plaku-

thashë, për të gjitha...

Lokja-

eh, ç`thashë edhe unë!

e ç`mund të thuhet për një nënë

të këtyre kohëve të çmendura!

me ç`fjalë do çilej shpirti i një nëne

që i dha gjak nga gjaku i vet

këtij dheu të përgjakur!..

Plaku-

ata do t`i thonë të gjitha ...

të gjitha çmenduritë e kohëve , që mbajti shekujsh

mbi kurriz

ky Dhé

i bërë shkrumb e hi...

Lokja-

ashtu u bëftë o im zot!

(skena e dytë...hapet dera dhe futet brenda ushtari
me emrin Arbër...lokja ngrihet e përqafton)

na harove, trimi i lokes...
na mbetën sytë nga dera...
prit sot e prit nesër e... u bëmë merak
s`kemi pasur as kë të pyesim...
në këto kohë! s`është mirë as të pyesish...

(ushtari pasi var armën në mur, ulet në një kënd)

Ushtari-

kam dashur të vi më heret, pooo...
luftë oj loke, luftë...

Lokja-

luftë or bir, luftë...

Ushtari-

qëkur i hodhëm armët supit,
nuk i përkasim më shtëpisë...
jemi nën urdhërat e Atdheut...

Lokja-

qenkan të rreptë ato urdhëra or bir...

Ushtari-

jo loke, jo...nuk janë të rreptë, por janë të shenjtë,
të shenjtë...dhe askush, përveç Zotit, nuk mund të
qëndrojë mbi to...

nën ato urdhëra jam i lirë...i lirë...

ndonëse kam vdekjen përkrahu,

nën ato urdhëra jam i lirë...

Lokja-

ky është hesapi kësaj dasme or bir...

Ushtari-

po oj loke, po, ky është hesapi i kësaj dasme...

Lokja-

po... ndonjë të re?..

Ushtari-

të re?..posi!..

kam një lajm, madje të mirë ,të mirë,të mirë,fare të
mirë...

(ngurron të thotë diç tjetër)

Lokja-

lajm të mirë në këto kohë!..

Ushtari-

Gëzimi dhe hidhërimi nuk zgjedhin kohë, loke!..
çuditërisht përngjajnë me vdekjet, vijnë pa u
lajmëruar...

Lokja-

në këto anë...
të gjitha kohët një fytyrë patën...

Ushtari-

kësaj here do të jet ndryshe, ndryshe...
me hir o me pa hir
do t`ua ndërrojmë fytyrën
edhe kohëve më kokëforta...

Lokja-

dhëntë Zoti or bir...

Ushtari-

kësaj here, ndryshe do flasin,
edhe pushkët edhe kohët...

Lokja-

dhëntë Zoti or bir!

dhëntë Zoti e çlodhet një herë kjo tokë,

të zgjohet një herë në paqe,

të zgjohet e buzëqeshur

në pranverat që po vijnë...

Ushtari-

prandaj gjëmojnë këto male,

që pranverat mos vonohen

e të fryjë jugë e ngrohtë

mbi dhimbjet e kësaj toke...

prandaj gjëmojnë këto male...

janë mijëra trima që marshojnë,

janë qindra mijëra nëpër botë

që kanë mathur armë e opinga

dhe janë nisur për Kosovë...

sot a nesër këtu i ke...

kjo tokë më s`do rënkojë,

se gjallë janë bijtë e saj...

gjallë, gjallë...

kësaj here do të jet ndryshe...
ndryshe do kërcasin pushkët,
ndryshe do flasin edhe kohët...
kësaj here do të jet ndryshe...

Plaku-

jo kësaj here o trim Drenice...
më mirë përherë thuaj...

pëherë faqebardhë dolëm nëpër fushat e mejdanit...
dhe larg na vajti edhe nami...
po ishin hilet e krajlive
ato që prenë fatin tonë...

Ushtari-

ato që prenë fatin mbrapsht...mbrapsht...
pooo...ato kohë...
ato kohë...kurrë s`do të kthehen në këto anë...

Plaku-

të lumtë goja o trim Drenice...

(ushtari ngrihet, afrohet tek frengjia dhe flet lehtë)

Ushtari-

eh, Zot o Zot...edhe lajmet që gëzojnë
të mbetkan si asht në fyt...kam frikë t`u them...
kam frikë t`u them: edhe pak kohë,
edhe pak çaste qëndrojnë në mes,
e do të shfaqen vet në derë...
do të shfaqet vet Fehmiu,
do të shfaqet edhe Xheva-nusja e këtij oxhaku,
nusja me njëmijë legjenda...
si t`ua them!.. si t`ua them...
si t`ua them që po vijnë...

e do të shuhet malli i zgjatur
që ka pllakosur këtë Dhé shqiponjash
këtu e dymijë vjet të shkuar...

(lokja mezi pret të dëgjojë lajmin)

Lokja-

thuaje lajmin një herë or bir,
se luftë është
e nëna jemi...

(ushtari shikon orën dhe ik nëpër kohë, kujton vitet e burgut, dhe përpiqet ta zvarrisë bisedën)

Ushtari-

Ju jeni më shumë se nëna...

Jeni shpirti i këtij dheu...

ehhh (rënkon thellë)

Lokja-

Ç`ke or bir!..

Të ta pjek lokja një kafe?!

Ushtari-

Jo, jo, pooo...seç m`u kujtuan vitet e burgut...

...sa herë na ndoqët në ato dyer...

saherë udhëtuat me ditë të tëra

me një kothee misri në brez...

sa herë erdhët e u kthyet

pa i takuar bijtë e bijat...

Lokja-

po or bir, po, u ndoqëm se ishim nëna,

dhe shpesh u kthyem...shpesh u kthyem pa u

takuar.

edhe në ato kondita, ky hasëm që po djeg vendin,
deshte të na poshtërojë, të na përulë...
kërkonte në gjuhë të tij të flasim me bijtë e gjirit...

eeh...të flasësh në gjuhë të hasmit
e të shihesh sy më sy me bijtë
që lindën për këtë Dhé,
kjo s`do të ishte veç trishtim,
kjo do të ishte një mallkim
që nuk e falë as Perëndia...

Ushtari-

ju jeni më shumë se nëna...
jeni shpirti i këtij dheu...
kush do të mbante një barrë të tillë!
kush do rrugëtonte me këtë barrë
shekull më shekull si uragan...

ju jeni më shumë se nëna...
jeni shpirti i këtij dheu...

(jashtë dëgjohen zëra të njohur...
...ushtari afrohet tek frengjia)

Ushtari-

erdhën, loke, erdhën...

bac, erdhën...(dëgjohet një breshëri plumbash dhe hapet dera...shfaqet si një mal Fehmiu, pas tij Xheva dhe disa ushtarë...pas një shikimi të gjatë sy më sy me loken, niset drejtë saj)

Lokja-

trimi lokes!..

loke! (mirren fort në përqafim)

(si shkëputet prej tij i drejtohet Xhevës)

Lokja-

malësorja e lokes...

Xheva-

loke...

(si përshëndeten të gjithë ulen kush si mundet...
...lokja nuk ia shqet sytë Fehmiut)

Plaku-

mirë se u pruri Zoti bijtë e mi...

Të gjithë-

mirë se u gjetëm...

Lokja-

(me zë të lartë)

ty të falemnderit o Zot,

(dhe i drejtohet Fehmiut)

të solli Kosova or bir...

Fehmiu-

po loke...Kosova!.. -(shkurt)

Lokja-

të sollën plagët e këtij dheu
që po rrënkon me mijëra vjetë
e s'iu gjend ilaç një herë...

Fehmiu-

po lokja ime...Kosova...plagët e saj...zëri i saj...
thirjes tënde nuk iu përgjigja,
por Kosovës i thashë, po...
po...ja ku më ke...
si mund t' i thosha, jo, atij zëri që pas më ndoqi
çdo orë e çast...
edhe në frontet e Kroacisë,
zëri i saj m`u bë kushtrim...
edhe atje Kosova m`thiri...zëri dhe gjëma e saj...

Lokja-

trimi i lokes, trim...

Fehmiu-

loke (dhe e shtrëngon në kraharor)

Lokja-

ta ndjeva hapin që larg or bir...
e çuditshme është ndjenjë e nënës...
ka kohë që të ndjej pranë,
ta ndiej hapin, frymën,
ta ndiej djersën e rrugëve të gjata...
e çuditshme është ndjenjë e nënës...

(Fehmiu e merr në përqaftim, pa folur)

(plaku i sheh nga koka tek këmbët dhe e kupton që
ata kishin kohë që kishin hyrë në Kosovë...)

Plaku-

si duket, qenke çmallë një herë me bjeshkët or bir...

Fehmiu-

po o bac, po, u çmalla një herë me bjeshkët,
se bjeshkët m' i hapën rrugët,
bjeshkët më prunë në Drenicë...

Plaku-

bjashkët kanë qenë udhët tona...
kanë qenë shtëpitë tona...

(shkëputje e shkurtër)

bjeshkët i dhanë nam Drenicës...

Fehmiu-

bjeshkët bac, bjeshkët...të vetmet kulla
që s`i merr zjarri...
të vetmet udhë, ku s`mund të shkelë
as këmbë shkjav as këmbë djalli...

atje fle liria jonë...

Lokja-

a u çmalle mirë or bir...
a e puthe pragun tënd!..

(pas një rënkimi të thellë)

s`gjendet ngushëllim më i mirë
për zogjtë që vijnë nga larg
në foletë që rritën krahët...

këtë zakon na e lanë të parët...

përunjeshin dhe puthnin pragun
përpara se të marrin udhët...

e kur ndodhte që të kthehen
ky adet përsëritej...

(Fehmiu kthehet e puth pragun dhe shkon tek
frenjia shtien me breshëri)

Lokja-

çmallu or bir, të pastë lokja...çmallu,
çmallu me këngët e Drenicës...çmallu!..çmallu!..

Fehmiu- (e sheh në sy loken)

...e kam një zjarr këtu në gji...(hesht)

Lokja-

është zjarr i zjarreve të dheut...
nuk shuhet aq lehtë or bir...

Fehmiu- (përsërit fjalët e lokes)

...zjarr i zjarreve të dheut...

(flet lehtë dhe shtrëngon armën)

(në fon)

dy mijë vjet këlthet europa,
thot` nuk di nga i bje Shqipnia,
thret mbi flakë Adem Jashari:
e ke këtu nën këmbët e mia...

bie perdja...

Akti i dytë

(në skenë: pleqtë, Fehmiu dhe Xheva)

(- është kohë ekzodi - nga jashtë vijnë zëra të papërcaktuar - dëgjohen dhe qarje fëmijësh ...Xheva shikon nga frengjia dhe nis ligjërimin)

Xheva-

për ku janë nisur këta karvanë!
ku po e çojnë këtë barrë shekujsh
që rëndon qafën e këtij dheu...

gjer ku do shkojnë me këtë barrë
që mbajnë mbi supë si një mallkim...

për ku shtegtojnë këta bilbila
ende pa i çelur sytë!..

(pas një ndërhyrjeje muzikore)

...sa qenke lodhur oj nën` Kosovë!..
të vajti jeta n`istikame...
as tu hoqën istikamet,
e as gjaku nga këmisha...

të tillë të kujtojnë shekujt,
përherë këmishpërgjakur...

eh...Kosovë...Kosovë!..
të shtrenjta...të shtrenjta i pate orët...

ta mohuan nusërinë,
t`i mohuan këngët, vajet,
vetëm nderin e lavdinë
s`ta mohon dot asnjë shekull,
asnjë vdekje, asnjë gjëmë...

(vazhdon të shikojë përmes frengjisë)

...jam jot bijë oj nën` Kosovë...
jam nderi dhe gjaku yt...
unë, që mallin larg ta ndjeva ...
larg...në udhë të pafundëta,
ku veç loti mik të bëhet...
...por lotë...s`më panë sytë,
lotë nuk më deshën sytë...

jo që nuk pata një lot për ty,
kam në shpirt një det me lotë...
por jo sot,
jo as mot,
gjersa ti kërkon barut,
të kam ardhur me barut... (ngjesh dorën në kobure,
jashtë shpeshtohen krismat)

Fehmiu-

dëgjoje Kosovën, Xhevë!
dëgjoji këngët e saj,
dëgjoje lavdinë e saj...

Xheva-

dikush ik
e dikush vjen...

Fehmiu-

askush nuk ik përtej vetvetes,
sado larg që të shkojnë,
sado larg që të ikin
Manastir, Shkodër,
Shkup, Janinë,
gjithandej një nënë i pret...
(pas një frymëmarrjeje)

askush s`e le pragun e saj,
askush s`e le gjirin e saj...

Xheva-

të shtrenjta i pate Orët, Kosovë,
të shtrenjta, të shtrenjta...

(përmes krismash dëgjohet marshi i UÇK-ës)
(Fehmiu i afrohet Xhevës i buzëqeshur)

Fehmiu-

Xhevë!

Kosova është ngritur peshë...
a i ndjen malet që po dridhen!
a i ndjen grykat si gjëmojnë...
Kosova është ngritur peshë...

(pas një shkëputjeje)

ky është zëri i këtij dheu...
ky është nderi i këtij dheu...

Xheva-

po këto djepa!
po këto këngë që therin shpirtin!
vallë!
a i ndjen kush!
a i ndjen kush këto zëra,
që mallkojnë nëpër shekuj!

Fehmiu-

janë zëra lufte, Xhevë...

Xheva-
edhe djepat?!

(ndërhyn lokja nga oxhaku)

Lokja-
edhe djepat janë Kosovë...oj bijë!

Xheva-
po, loke...

(lokja e ndërpret)
kjo është rruga e Kosovës...
rrugë tjera s`njeh ky vend...

Xheva-
loke! (i hidhet në përqaftim)

(pas një pjese muzikore)

Fehmiu-
ikëm edhe ne dikur,
askush s`mban mend në ç`kohë u nisëm,
nuk matej koha ahere
nuk kishte matës kohe,
as gjurmët ndër këngë malli
nuk dihet nga ç`kohë mbetën...

nuk matej koha ahere
as që kishte kohë fare...
as unë, që njoha e preka dhimbjet e kohës
nuk mbaj mend gjë...

(afrohet nga publiku)

di që u nisa një natë pa hënë,
një natë të errët
një natë të ferrtë...
ishte një kohë,
një kohë...
kur vet dielli druhej të zbresë
mbi çatitë e kullave të mia,
kur veç pjellë e errësive
çilte zogjë në këto anë...
askush s`mban mend në ç`kohë u nisëm,
askush nuk flet për ato kohë,
ikën pas Diellit, thonë,
mbase do zvargen gjer buzë varrit
dhe prap do kthehen këtu të vdesin...
eh...ahere
asa ujë për të lagur buzët s`kishte,
qenë lodhur krojet e lashtë,
qenë terur,
qenë tharë...
eh...sa këngë lindën e s`u kënduan...

(pas një pjese muzikore)

unë jam njëri prej tyre,
unë që ndoqa pas pranverat
e veç dimra pashë me sy...
e gjatë është udhë e nderit...
e gjatë...
që nga djepi i fëmijërisë
gjer tek prehëri i perëndisë...

(pas një heshtjeje)

s`di në dremita ndonjëherë,
por di që kurrë në sytë e mi
ëndërr e verdhë s`gjeti vend...
pranverë i pata ëndrrat,
pranverë e shpirt pranvere...
edhe kur lidheshin stinë të vrugëta
si gërsheta gjarpërinjësh
dorën dëshpërimit kurrë s`ia shtriva,
shpirtin pendimit kurrë s`ia dhashë...

unë jam njëri prej tyre,
unë që njoha gjuhën e zogjëve
dhe hyra vet në këngë të tyre...

unë, që eca nëpër shekuj
me tabanë të përgjakur...

sa herë m`i priste udhët një këngë,

pa adresë, pa autor...
një këngë e mbetur nëpër kohë:
„inshallah vjen ndoj devër tjetër“...
inshallah, inshallah...
ia priste i dyti, i treti i pesti...
dhe kënga ikte udhë më udhë
ku flinin karvanë shekujsh
me shpresën e blertë në sy...

dhe mali dhe fusha dhe deti
i mbanin ison e përvajshëm...
eeh...Atdhe...
kam mijëra shekuj që udhëtoj,
mijëra ëndrra mbushur me mall
për pragun tënd,
për nderin tënd...

(pas një lëvizje skenike afrohet tek sofa
e varur në mur)

...e ti...kur s`pate bukë e kokërr kripe
zembrën time ja shtrove mikut...

Xheva-(tek frengjia)

kur do këputen këto zinxhirë
që mbajnë lidhur lirinë tënde!
kur do përmbysen kjo epokë
që lahet me gjakun tënd!..

gjer kur do lajshë udhët me gjak
që të të shkojë zëri larg
gjer kur, gjer kur...
askush s`përgjigjet... të gjithë heshtin,
të gjithë heshtin kur klith ky Dhé...

Fehmiu-

përgjigjen e ke në brezin tënd...
e ke në çarkun e nagantës,
asaj besoi, vetëm asaj...

Xheva- (ngjesh dorën në brez)

Fehmiu- (flet me publikun)

Kosova nuk lidhet më,
nuk gjenden zinxhirë të tillë që e lidhin këtë Dhé,
...këtë Dhé...

që u pre e u gri
sa me shkja, aq me azi...
Kosova s`është më foshnjë,
s`lidhet më në djep sulltanësh,
as me konferenca lordësh,
as me hile karpatjanësh...

Kosova nuk lidhet më...

Xheva-

mjaftë më...
mjaft më o bastardë të nëmur...

mjaft më e ushqyet veten me mite e me legjenda
që ia vodhët dheut tim...

mjaft më me ata „shenjtorë“, - me ata kambana
vdekjesh, që ia vodhët dheut tim...

mjaft më o soj i pasoj...

mjaft më...

i shterën gjiret shtrigës plakë

që u ushqe u mbi njëqind vjet...

mjaftë më...

o të pa besë ...mjaftë pas krahësh derdhët zjarrë,

dilmëni një herë në shesh

dilmëni një herë përballë !..

(bie perdja)

Akti i tretë
(krisma të rënda)

Xheva-
kjo është gjuhë e kësaj bote...
mbi këtë gjuhë ndërtohet paqja
(tregon me dorë nga vijnë krismat)

...ç`ironi e trishtë...

Fehmiu-
...ironi e kohës...

Xheva-
e të gjitha kohëve...

Fehmiu-
ç`gjuhë i mbeti kësaj bote!

Xheva-
gjuhë plumbash, vdekjesh , varresh...

Fehmiu-

sa shpesh patëm ëndërruar,
sa shpesh ëndërruam kot...

ëndërruam degë ulliri...

degë paqe...

dhe deshëm me degë ulliri të përmbyllim
rrugëtimet.

por...kot...paskemi parë ëndrra kot...

(kap revolverin në brez)

...këtë gjuhë njeh kjo botë...

Xheva-

dhe na thonë të mbyllim gojën...

të heshtim se prishim paqen...paqen...

t`i mbyllin të gjitha shtigjet

të përdhosin erz e nder

dhe të thonë: të mbyllësh gojën!

pooo...

edhe po deshëm të heshtim ne

do flasë gjëmë e këtij dheu,

do flasë palcë e këtij dheu...

do ulërijnë fusha e male...

do flasë dhe guri i ftohtë mbi varre...

Fehmiu-

nuk heshtin dot „shën stefanët“,
kongreset e konferencat...
nuk heshtin dot historitë,
nuk heshtin dot tradhëtitë...
eeeh...Kosovë
s`pate udhë për të zgjedhur,
o të shtrohesh e koritun,
o të ndizesh me gjithë ç`ke...

ky mallkim të ndjek për mot
o e shenjta ime tokë...

(krismat vazhdojnë)
(Xheva tek frengjia)

qëndro Kosovë, qëndro!..
qëndro siç di të qëndrosh...
mos duro më lotë fëmijësh
në pranverat që po çelin...
qëndro,kosovë,qëndro...

(largohet nga frengjia)

qëkur zbritën egërsirat
nga akullishtë e sibirit
s`i panë sytë pranverë pa lotë...
s`i panë sytë stinë pa gjak...

po kosova do qëndrojë,
do qëndrojë e do fitojë...
s`kanë më forcë as perënditë
t`i mbyllin udhët e saj...

fati saj tani është shkruar,
është vulosur e firmosur
tek bedenat e Prekazit...

Fehmiu-

nuk ka zjarr as tym as flakë
që matet me këtë zjarr
(tregon kraharorin)

...është zjarr prej mijëra zjarresh...
që s`e ndal më asnjë zjarr
e asnjë dreq e asnjë djall...

Xheva-

edhe vet kancelaritë
këtej e andej evropës
po e ndjejnë këtë tërmet...

Fehmiu-

e ndjejnë dhe do ta ndjejnë
edhe në shtëpitë e tyre
po qe se dalin në rrugë
të pengojnë rrugëtimin tonë...
...rruga jonë s`ka kthim prapa... (flet rreptë)

Xheva-

gjer të gjejmë dhe ne një paqe,
me paqe ose me plumba...

Fehmiu-

eeeh...

e duam, zotërinjë qejfesh e sallonesh,
e duam dhe ne një... paqe...

një paqe,
që dymijë vjet
e brez pas brezi
po i falemi stinë më stinë,
por jo paqe...jo paqe që mban peng
lirinë tonë nëpër shekuj...

joooo...zotërinjë qejfesh e sallonesh, jooo...
paqe të larë me gjakun tonë
nuk është mirë të ëndërroni...

këto kohë do flasin ndryshe...ndryshe...
dëgjoni malet e Kosovës,
dëgjoni zogjtë e këtij dheu
që presin paqe dy mijë vjet...

dy mijë vjet nëpër male...
se paqja juaj na i shkrumoi
me qemerë me gurë me kulla...

se paqja juaj na i përgjaku
fusha, male, tokë e qiell...
se paqja juaj na i helmoi, burime, kroje e
lumenjë...
dhe prap na thoni që të heshtim...
të heshtim për hir të paqes...
të paqes që na përgjak,
që na vret,
që na helmon...

(ngre zërin)

jooo, zotërinjë qejfesh e sallonesh,
këto kohë do flasin ndryshe...ndryshe...

(Xheva i fshin lotët fshehtas, mirëpo lokja e
përvjedh)

Lokja-

(duke trazuar prushin me mashë)

lëshoje lotin oj bijë...
lëshoje lotin...
shpirtit që rënkon nga dhimbja
i duhen dy pika lot...

Xheva-

Loke...

Lokja-

Qajnë dhe malet ndonjëherë,
po përsëri male mbesin...

(krismat shpeshtohen)

ky vend me bollëk i pati
si këngët, ashtu dhe lotët...

Xheva-

Loke...

Lokja-

(vazhdon ligjërimin pa i vënë veshin)

...natën iknin, natën vinin burrat e pushkës...
po kurrë s'ndalëm
e kurrë s'pushuam...
me djepat plot punuam tokën,
ku të ngrënë, ku të pa ngrënë...
ku në shi e ku në borë...
ky vend, të gjitha me bollëk i pati...

(Fehmiu e Xheva e shohin si të magjepsur)

Xheva-

Poooo...a lodheshit ndonjëherë oj loke!..

Lokja-

eeh...moj bijë...
nënat nuk dinë të lodhen,
se lodhja e tyre e lodh Atdheun,
...lodhja e tyre...e shtron Atdheun...

...toka kërkonte djersë prej nesh,
kërkonte nder,
kërkonte gjak...

dhe veç një ditë po t`ishim lodhur
do t`ishte bërë kijameti...

Xheva-

(nën heshtje)

eh...Zot o Zot...
ku e gjen forcën ky shpirt mitik
që fali ç`pati për këtë Dhé
dhe fshehu dhimbjet përherë prej tij...

ulet e puth si një fëmijë,
i këndon lavde përmbi djep,
i bën hallall gjakun e bijve...
i bën hallall dritën e syve
dhe prapë qëndron, qëndron, qëndron...
eh...Zot o Zot...
përballë Qëndresave të tilla
edhe shkëmbinjtë bien më gjunjë...

mjafton të shohësh sytë e saj,
ku mund të fshihen mijëra lotë,
ku mund të fshihen mijëra dhimbje,
për të kuptuar pastaj më mirë
pafundësinë e atij deti
që fsheh misteret nëpër kohë...

Fehmiu-

vështirë të mbiste gjallë ky Dhé
pa këta sy të perëndishëm
që fshehën lotë, dhimbje e mall
nga sytë e brishtë të lirisë...

vështirë të mbiste gjallë ky Dhé
pa këtë simbol të perëndishëm
që i dha nam e i dha nder
e i dha emër rrugës sonë...

eh...emri im,
dheu im...

veç ty të priten lisat në male,
veç ty të digjen pragjet e kullës,
veç ty të të varin në degë lisi,
veç ty të djegin me duarlidhur...
veç ty të nëmin po hape gojën...

eh emri im,
dheu im...të erdhën e t`ikën nëpër çdo kohë
nomadë shpellash e bij nomadësh,
dhe saherë pushkën ua ktheve
aq herë nëmje të dha evropa...
eh, emri im...
vetëm ti fjalën luftë
e merrë për shenjim shpëtimi,
e merrë si urë mbikalëse,
ku njëri brez përcjellë tek tjetri
flamurin e rezistencës...

(lokja fare pa pritur përsërit fjalët e fundit)

...vetëm njëditë po t`ishim lodhur
do t`ishte bërë kijameti...

i kemi borxh kësaj toke...
sa bij nënash ia falën gjakun,
sa dyer kullash u mbyllën
e kurrë më nuk u hapën,
që të mbes hapur derë e Atdheut,
që të mbes hapur derë e Kosovës...

i kemi borxh kësaj toke...
në s`mund t`i bëni ndonjë të mirë,
së paku mos e pështyni
se pështyni bijtë e saj...
pështyni mbi nder të saj...

(ngre zërin)

(Xheva-i afrohet afër dhe ulet në një shkëmb...
përpiqet ta largojë nga kujtimet e thella, por, kot)

Xheva-
Loke...

Lokja-
eh, moj bijë (krismat s`pushojnë)

kjo tokë...kjo tokë... (...dhe vazhdon me
shkëputje)

është e tëra një Pranverë...
është më shumë se një Pranverë...
ngado që të hedhësh sytë
të mbushet shpirti me jetë...

thonë se Dielli i parë
në këto anë paska lindur...
që këtej pastaj merrë udhët
dhe harron të kthehet prapë...

Xheva-
Loke...

Lokja-

po moj bijë, po...

edhe ky tym, edhe ky zjarr

s`i prekin dot hiret e saj...

ngado që të hedhësh sytë

të mbushet shpirti me jetë...

është tokë e mbjellë me varre trimash...

është tokë e mbjellë me flakë e zjarre...

me zjarre i priti lindjet,

me zjarre i priti vdekjet...

është tokë zjarresh...

tokë zjarresh...

Fehmiu-

Bac!..

Plaku- (e kuptoi se i biri deshte një fjalë)

të gjitha fjalët po i thotë pushka or bir...

Fehmiu-

atëhere, na prift e mbara...

Plaku-

e mbara dhe e drejta

gjithmonë ka mbajtur anën e forcës,

edhe këtë herë s`bëjnë përjashtime...

e doni të mbarën! -e duam do thoni ju!
e doni të drejtën! -e duam do thoni përsëri!..
e pra...e mbara dhe e drejta fitohet në front!
ligje të tjerë nuk njih kjo botë...
po humbi fronti,
humbet dhe e mbara bashkë me të drejtën...
prandaj qëndroni...
...qëndroni fort e të na nderoni!..

Fehmiu-

...t'u bëftë bekim fjala o bac!..

(i kthehet lokes)

e ti loke!..kur të kthehem...
dua me këngë të më presësh,
pavarësisht në vi me erën
a në krahë të ndonjë zogu...
dua me këngë të më presësh...
dhe larg të ndjehet ajo këngë,
të kalojë mbi shtatë palë male,
të kalojë mbi shtatë palë qiej,
se buzëqeshjet po i falim,
që të këndojnë këto male,
që të këndojnë këto qiej...
që të këndojë e kurrë mos ndalet...
ky Dhé i djegur për Liri...

Lokja- (e emocionuar, por e fortë)
hallall gjirin bijtë e mi...
nënat s` kanë tjetër bakim...

për këtë Orë ju kemi rritur...
për këtë Orë e për këtë ditë
kënduam këngë mbi djepat tuaj...

(me shkëputje)

që zot t`i dilni kësaj Ore,
që zot t`i dilni kësaj dite...

...dhe amanetin mos e harroj...

mbi nder të kësaj toke o bij
s`mund të shkelë as jeta juaj...

Fehmiu-

Loke...(përqafohen, rrëmbejnë armët bie
perdja)...

Akti i katërt

(ngjarja zhvillohet në natyrë...lëvizje ushtarësh...
...ndërkohë vjen Fehmiu i shoqëruar nga Asllan
Fazliu,BURRË RRETH 35-40 VJEÇ, i cili i rri
pranë gjithë kohën, dhe fillon një fjalim përpara
ushtarëve...krismat nuk pushojnë)

Fehmiu-

trima!..

këto dallgë zjarresh

që zbresin tërbimshëm nga shekuj epikë,

janë këngët e vetme

që i lanë në derë historitë makabre

dheut tonë të shenjtë...

janë hire dhe mite të udhëve të tij,

janë udhët e tij...

janë udhët që shkelën gjyshër e stërgjyshër...

kur kishim për shpirti veç një maliher

me dy-tri fishekë

dhe plisin e bardhë lëshuar mbi sy...

këto dallgë zjarresh e rrebeshë plumbash,

që po përcëllojnë damarët e dheut

presin flakën tonë,

presin zjarrin tonë...

flakë për flakë e zjarr për zjarr... (me zë të ngritur)

Ushtarët- (njëzërit)

flakë për flakë e zjarr për zjarr!..

flakë për flakë e zjarr për zjarr!..

flakë për flakë e zjarr për zjarr!..

Fehmiu-

mbi këtë Dhé që po qëndrojmë

sot e mijëra vjetë të shkuar,

të parë e të mbramë qemë ne,

të parë e të mbramë jemi ne...

të parë e të mbramë do mbesim ne!..

kjo tokë nuk rriti tjetër farë

sado që u lodhën nomadë e barbarë...

me zjarre na erdhën,

me zjarre i pritëm...

dhe po me zjarre do t'i përcjellim...

shikoni...

shikoni mbi këto male,

shikoni mbi këtë qiell...

shikoni yjt e Drenicës,

shikoni yjt e Kosovës...

mbi flakë tek flakërojnë...

shikoni tek vijnë Jasharët me zjarret në kraharor...

shikoni tek mbajnë në grushte shkrepitima e
meteorë...

shikoni Azem Galicën
me një maliher në dorë...

shikoni, bajraku i shqipes
mbi bajraçe errësie
nëpër shekuj tek valon...

shikoni se erdhi Ora,
shikoni se erdhi dita,
që fjalën ta thotë e fundit
me barut siç di Drenica...

Ushtarët- (njëzëri)
Përpara Komandant!..

flakë për flakë e zjarr për zjarr,
flakë për flakë e zjarr për zjarr,
flakë për flakë e zjarr për zjarr...

Fehmiu-
(i buzëqeshur si gjithnjë)
trima!..
siç jemi marrë vesh:
vetëm një fishek...një fishek një kokë!..

Asllani- (një shaka e zakonshme)

Komandant!..më fal pooor
pushka ime i shkrep nga dy,
sikur nuk di të kursejë!..

Fehmiu- (ia kthen shakanë)
nëse qëllon të njëjtin ballë
hallall i ka edhe tri!..

Ushitari i parë-
për këto harxhime të kota
propozoj që të dënohet...

Ushitari i dytë-
edhe unë jam dakord...

Ushitari i tretë-
eee, ç`dënim propozoni!..

Ushitari i katërt-
të fillojë këngën i pari...

Të gjithë njëzëshëm-
dakord...

Asllani-
unë s`di të këndo, por di paksa të recitoj...

Të gjithë njëzëshëm-
fillo!..

Asllani-

dëgjo mirë o car milloshi,
këtu Llazari i la patkojt,
jam i lashtë, jam gjak arbnor,
jam Drenicë me farë me soj...

(duartrokitje)

Fehmiu-

tash...
secili në vendin e vet...

Njëzëshëm-

si urdhëron Komandant!..

(të gjithë marrin pozicione lufte...
...krismat shpeshohen...plagoset rëndë Fehmiu...
vritet Fatimja...
...Asllani që i rri pranë e sheh të përgjakur...)

Asllani-

baca Feh!
më duket se të nderoi Zoti...

Fehmiu-

për këtë nder jemi betuar...

Asllani-

baca feh!..(i zbret padashur një pikë lot)

Fehmiu- (ia sheh lotin)

qëndro o Asllan Fazliu,
mos ia prish nurin Drenicës...

Drenica s`ka kohë të qajë,

Drenica s`ka kohë për kujë,

Drenica di të këndojë,

Drenica di të qëndrojë,

Drenicës s`i dalin lotë,

Drenica s`ka kohë për lotë...(kollet rëndë)

qëndro o Asllan Fazliu!..

Asllani-

do qëndrojmë Komandant...

(fjala komandant mezi i del nga goja)

do qëndrojmë

me ty në ballë...

Fehmiu-

Asllan!

në ballë kemi veç flamurin...(flet me vështirësi)

Asllani-

Komandant!

Fehmiu-(hedh sytë tek valvitet në shtizë Flamuri)
në ballë...në ballë...ai...ai s`guxon të bie
poshtë...
ai s`guxon të bie poshtë...

Asllani-

baca Feh! (i duket më i afërt me këtë emërtim)
sot...edhe ti...edhe ti...(i dridhet buza)
më dukesh si një Flamur,
që tund krahët mbi Kosovë
kudo që thërret liria...
baca Feh!..sot...edhe ti...
u shndërrove në Flamur...
shiko ç`nur të ka marrë trupi!..
(Fehmiu është i mbuluar në gjak)
u shndërrove në Flamur...

Fehmiu-

qëndro he burrë i dheut!..
(flet rëndshëm me shkëputje)

Asllani-

më fal Komandant...më fal se u korita...
DRENICA nuk i njeh lotët...
as sytë e mi s`njohin lotë...
po...nuk e di...
nuk e di në ishte lot ajo pikë dhimbje mbi qerpikë!

mbase ka qenë një pikëz vese
nga sytë e shenjtë të perëndisë,
që zbret prej motesh mbi Kosovë
të shpërlaj plagët e dragojve!..

Fehmiu-(gjithmonë i buzëqeshur)
Asllan...hfff...

Asllani-
je zbukuruar Komandant...

Fehmiu-
ky është çmimi i jetës sime...
të bëhem gjak i këtij dheu...

(ndërkohë afrohen katër ushtarë)

Ushtari i parë-
të qenka skuqur këmisha o bac...
të paska marrë ngjyrë lulëkuqesh...

Ushtari i dytë-
të paska dhënë ngjyrë Kosova,
t'i paska dhënë huret e saj...

Fehmiu-
është fati im më i madh
të vishem me ngjyrat e saj...

Ushtari i tretë-

ky është nuri i trimërisë!

Ushtari i katërt-

ky është nuri i burrërisë...

Fehmiu-

trima!..rrethi i vdekjes po ngushtohet...
dëgjomani fjalën e fundit...

(flet rëndshëm dhe me shkëputje)

të plagosurit dhe civilët...bashkë me ju...
të tërhiqeni menjëherë...

Ushtarët (njëzëshëm)

Komandant!..

Fehmiu-

po e them të fundit fjalë...
tërhiquni menjëherë...

Ushtarët (njëzëshëm)

Komandant!..

Fehmiu-

është urdhër i prerë...

Ushtarët (njëzëshëm)

Komandant!..

(skena e dytë...në skenë Fehmiu i plagosur...
...Xheva e plagosur...më tej Fatimja e vdekur)

Fehmiu-

sa gjatë ke pritur oj nën` Kosovë,
sa shekuj të morën flakët e namin s`ta dogjën dot,
sa zjarre të ranë në pragje e këngët s`ti ndalën dot,
sa vdekje t`i morën bijtë e krismat s`ti shojtën dot,
eh...Atdheu im, Atdhe...

...këtë grusht gjak që na dhurove
themelit tënd po ia kthej...

uhhh...

erdhi çasti që e kam pritur...

ky është çasti që e kam pritur...

të shihemi sy më sy

me horrat e carëve rusë...

(kthehet nga Xheva)

...edhe ti Xhevë...edhe ti duhet të nisesh...

(shikon Fatimen të larë në gjak)

Fatime!..Fatime oj bijë...
nisu...nisu...
mos ia thyej fjalën bacit...

Xheva-

gjer te ky çast
tok udhëtuam...
tok e mbajtëm në sy Kosovën,
tok e ndoqëm lirinë e saj...
e sot...
më urdhëron të largohem..
e ku mund të shkojë një trup pa shpirt!..
ne s`patëm një shpirt të dytë
që vërtet të ishim dy...
udha jonë qe e gjatë,
e gjatë sa ëndrra jonë,
por ne kurrë s`u bëmë dy,
kurrë s`mundëm të ishim dy...
këtë Orë kemi pritur,
për këtë Orë jemi betuar:

këto vargje me fishekë (tregon fishekët)
pa u djegur një për kokë
nuk lëviz nga istikami...

Fehmiu-

Xhevë... (veç i buzëqesh)

Xheva-

(kthehet nga publiku dhe flat lehtë)

kjo buzëqeshje...
sikur më tremb,
sikur më thotë diçka në shpirt...
jo, jo...jooo!..
Fehmiun nuk e merrë vdekja,
nuk gjendet vdekje që rrezon lisat...
eee...sa dyer burgjesh
deshën ta shembnin!..
sa fronte luftërash deshin ta marrin!..
por...as e shembën, as e morën...

as kjo murtajë që i rri mbi kokë
nuk mund t' i dalë ballë për ballë...

pooor...
thonë se vdekjet janë tinzare,
të pa besa,
si vet dora që i ka sjellë
nga trualli i djalltë karpatian...

(tërhiqet në pozicion lufte)

jo, jo, Fehmiun nuk e merr vdekja...

(pushim muzikor)

...e ti Fatime...

përse i ndale buzëqeshjet...

buzëqeshi nën` Kosovës...

buzëqesh me tërë fuqinë...

që ta ndjejnë bijtë e vdekjes,

se këtej nuk kanë punë vdekjet,

se Kosova s`di të vdesë...

Fatimja-

(e përgjakur gjer në fyt, ngrihet më këmbë)

e kush thotë se vdes Kosova!..

kush e do vdekjen e saj!..

jo, jo...ja shikomëni!.. unë jam një copëz Kosove,

unë jam një copëz e saj...

unë...që njëzet pranvera i fala sot nderit të saj...

(kthehet në pozicion lufte)

Xheva-

(e përgjakur gjer në fyt)

gjëmo oj nënë Kosovë, gjëmo!..

si njëherë e njëherë moti

kur kishe në ballë Abdylin, Ymerin e Mic
Sokolin...

gjëmo oj nënë Kosovë, gjëmo!..

e le të tunden këto male, që hije i bëjnë burrërisë,

e hije i bëjnë Pranverës që ka zënë të buzëqeshë...

gjëmo oj nënë Kosovë, gjëmo!..

(krismat shpeshtohen)

...për këtë gjëmim të erdhëm sot...

(pushim i shkurtër muzikor)

...na falë oj nënë...
na bëj hallall se t`u vonuam...
po udhët nënë, udhët me tela t`ishin zënë...
gjersa u ngrit Adem Jashari
mbi shtatë palë vdekje si rrufe,
e u vërsul mbi djajt e zi,
e u vërsul mbi perëndi,
me burra, gra e me fëmi,
me farë me fis me katandi
dhe dogji tela e kufi,
dhe nuk do ket më dy e tri,
po do ketë veç një Shqipëri...

(ngrihet zëri në mbyllje)

(fillon lufta, në fon Dervish Shaqa:
moj Shqipni mos thuj mbarova...)

(nën këto tinguj bie perdja)

FUND

16.12.2011
Lebit Murtishi
Bern

Libra të botuara:

"Te kulla e Adem Jasharit", (poezi) 1999

"Përmes Shqipërisë", (poezi) 1999

"Harku i Lahutës", (poezi) 2000

"Jam Unë", (poezi) 2005

"Këtu jam që sot e mot", (poezi) 2006

"Sfida dhe kurthe", (Publicistikë) 2006

"Mall i gjakut tim", (poezi) 2007

"Pelegrinë në Janinë", (poezi) 2007

"Maratonë e heshtur", (poezi) 2008

- "Klithmë e nëndheshme", (poezi) 2008
- "Dolli e gjakut", (poezi) 2009
- "Udhët e yjve", (roman) 2009
- "Ankthi i artë", (roman) 2009
- "Vargu magjik", (roman) 2009
- "Nën lëmshin e kohëve", (satira dhe tregime) 2009
- "Stinë pa diej", (poezi) 2010
- "Ky Dhé ka zot", (monodramë) 2010
- "Vargu Magjik II", (roman) 2011
- "Kosova nuk di të vdesë", (dramë) 2011